



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MEMALIAJ
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN DHE KADASTRES

RELACION TEKNIK

Segmenti rrugor nga rruga nacionale deri nvarrezat e lagjes Shytaj (lidhet me pjesen e shtruar me rere bituminoze) ka një gjatësi prej 1410 m dhe gjerësi mesatare 3.50 m. Aktualisht është rrugë me cakell, e amortizuar nga përdorimi dhe kushtet atmosferike, me gropa, deformime dhe pabarazi që vështirësojnë qarkullimin. Ky segment krijon mundësi të lidhjes Krahes I poshtem me Krahes I siperm me rrugën Nacionale dhe krijon unazën që lidh me Njesinë Administrative Krahes dhe me fshatrat e Mallakastres. dhe Krahes

Materiali ekzistues ka humbur aftësinë mbajtëse.

Investimi është i domosdoshëm për të përmirësuar aksesin e banorëve, transportin e produkteve bujqësore dhe lidhjen me shërbimet publike.

Parashikohen: sistemimi dhe profilimi i trupit të rrugës; furnizimi, përhapja dhe ngjeshja e dy shtresave stabilizant dhe binder. Punimet do të përmirësojnë kapacitetin mbajtës, sigurinë dhe jetëgjatësinë e rrugës si dhe sigurinë e qarkullimit.

Specifikime Teknike

- Shtresa e stabilizantit me $t = 10$ cm me material guror të pastër, pa argjilë dhe lëndë organike.
 - Materiali gur natyror i thyer i pastër pa argjilë, pa papastërti.
 - Granulometria 31.5mm- 40mm.
 - Shtresa laget, ngjeshet, me rul deri 95% të densitetit.
- Binder asfaltik me trashësi 6 cm pas ngjeshjes
 - Perberja e binderit të jetë në përputhje me standartet teknike
 - Agregatet duhet të jenë të forta, të pastra pa argjilë, pa lëndë organike
 - Filleri mineral të jetë me granulometri të imët për të siguruar lidhjen sa më të mirë të bitumit dhe agregateve
 - Bitumi duhet të jetë I klases 50/70
 - Shtrimi të bëhet me finisher dhe ngjeshja me rul vibrues

Punoi
Ing. L. Mici
Top. P. Hoxha

